

UDHËZIM
Nr. 858, datë 25.7.2025

**PËR PROCEDURËN E REKRUTIMIT TË PUNONJËSVE NË AGJENCINË
SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe neneve 9 dhe 11, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, në funksion të përmirësimit dhe mbarrëvajtjes së veprimtarisë administrative të ASHK-së,

UDHËZOJ:

**I. PROCEDURA E REKRUTIMIT TË PUNONJËSVE NË AGJENCINË SHTETËRORE
TË KADASTRËS**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kryen evidentimin e numrit të përgjithshëm të vakancave në të gjithë strukturën e saj, si dhe drejtorive/zyrave vendore për të cilat duhet të kryhet procedura e rekrutimit, të evidentuara sipas pozicionit të punës dhe kërkesave të veçanta për sa i përket formimit profesional respektiv.

2. Pas evidentimit, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, bëhet shpallja e vendeve vakante në faqen zyrtare të ASHK-së, afishohet në ambientet e publikimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive/zyrave vendore, si dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit. Në shpallje përcaktohen vendet vakante për konkurrim, sipas drejtorive/zyrave vendore, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, si dhe afati i dorëzimit të dokumenteve në rrugë elektronike brenda afatit kohor të caktuar nga dita e shpalljes.

3. Drejtori i përgjithshëm i ASHK-së, miraton me urdhër krijimin e Komisionit të Vlerësimit, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, dy prej të cilëve janë punonjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe një anëtar i jashtëm me profesion pedagog/specialist i fushës.

Në këtë urdhër përcaktohen detyrat e komisionit lidhur me procedurën e konkurrimit, ndër të cilat dhe hartimi i tezës së testimit me shkrim dhe pyetjeve të testimit me gojë.

4. Anëtari i jashtëm i komisionit, specialist i fushës për profilet jurist/inxhinier/ekonomist etj., përzgjidhet nga Universiteti i Tiranës, pas kërkesës për vendosje në dispozicion nga ana e ASHK-së.

5. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit nënshkruajnë në çdo rast, deklaratën e paanshmërisë në përzgjedhjen e kandidaturave sipas profileve përkatëse. (jurist/inxhinier etj.).

6. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore kryhet verifikimi paraprak i dokumentacionit (dosjeve) të depozituara nga kandidatët në lidhje me plotësimin e kërkesave të posaçme dhe kriterëve të përgjithshme duke u mbajtur procesverbali përkatës.

7. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga kandidatët, kryhet në adresën elektronike njoftimi i të gjithë kandidatëve të kualifikuar, duke i njoftuar lidhur me datën, orën dhe vendin e zhvillimit të testimit me shkrim. Kandidatët e skualifikuar njoftohen në lidhje me skualifikimin nga procesi duke i njoftuar edhe të drejtën dhe afatin e ankimit.

8. Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do t’u nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit, nga komisioni i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë;

Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë; eksperiencën e tyre të mëparshme, si dhe motivimin, aspiratat dhe pritsshmëritë e tyre për karrierën.

c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë.

Kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistën e strukturuar me gojë kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim mbi 20 pikë.

9. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në fazën e fundit të testimit me gojë njoftohen elektronikisht në lidhje me pikët e mbledhura dhe informohen nëse janë kandidatë fitues. Gjithashtu, ata njoftohen për plotësimin e dokumentacionit (dosjes) fizike sipas përcaktimeve përkatëse.

10. Pas çdo fazë të procedurës së vlerësimit, në përputhje me parimin e transparencës dhe të dëgjimit të palëve në proces administrativ, në çdo njoftim të kryer kandidatëve jo fitues, në secilën fazë të konkurrimit, i lihet në dispozicion dhe një afat për ankimin e rezultatit. Për çdo ankim mbahet procesverbal/vendim përkatës, lidhur me pranimin ose jo të ankimit.

11. Drejtori i përgjithshëm i ASHK-së, miraton me urdhër krijimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli